



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 43

Prishtinë, më 20.11.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N/204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Frashër Krasniqi, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Jelena Bontiq dhe Shkumbin Demaliaj.

Mungoi: Bilall Sherifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha- OSCE; Erblina Ajazi- praktikante ; Niman Hajdari- Avokati i Popullit; Drita Vitia- Radio Kosova; Shaban Murturi, Edita Kusari, Albana Gjinolli dhe J.M - EUSR; Blendon Arifi- praktikant; Valentina Demolli- KMDLNJ; Ardita Hajra- Aktiv; Ardita Sylejmani- RTK; Besjana Bajrami- EO; Genc Nimani-Çohu; Egzon Murturi- KDI; Arbisa Shefkiu- Kallxo.com; Mirjeta Duraku- Kosova Press; Abelard Tahiri, Albulena Sylaj Zeqiri dhe Ardian Bajraktari- MD; Nehat Thaçi- SHKK;

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci, Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 9.10.2018;
3. Diskutim lidhur me gjendjen në Qendrat e Paraburgimit dhe Qendrat Korrektuese në Republikën e Kosovës;

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr.06-L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr.06-L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
6. Shqyrtimi i Raporteve të Komisioneve Kryesore për Projektligjin nr.06-L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004-32 për Familjen i Kosovës;
7. Të ndryshme;

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja konstatoi se miratohet rendi i ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 9.10.2018;

Kryetarja konstatoi se u miratua pa vërejtje procesverbali i datës 9.10.2018.

3. Diskutim lidhur me gjendjen në Qendrat e Paraburgimit dhe Qendrat Korrektuese në Republikën e Kosovës;

Kryetarja, tha se për të diskutuar këtë çështje, të ftuar janë z.Abeldard Tahiri, ministër i Ministrisë së Drejtësisë dhe z.Nehat Thaçi, drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues. Ajo shtoi, duke thënë se duhet të adresohen disa çështje tek shërbimi korrektues, si problemet që i kanë stafi, problemet që i kanë të paraburgosurit apo të burgosurit, po ashtu, çështja e hapjes dhe mbylljes së disa qendrave, siç ishte rasti i fundit në Pejë, dhe gjithashtu do të duhej të adresohet plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, sepse janë disa kërkesa të vazhdueshme që bëjnë të burgosurit.

Abeldard Tahiri, tha se tashmë është proceduar në Qeveri Projektligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe besoj që sot do të mbahet mbledhja e Qeverisë dhe nesër do të jetë pjesë e rendit të ditës për miratim ky Projektligj. Në të janë adresuar disa prej çështjeve dhe shqetësimeve, që kanë qenë edhe të mëhershme, të atyre që janë duke vuajtur dënimin nëpër qendra korrektuese. Një çështje e rëndësishme në kuadër të ligjit është edhe për pozitat drejtuese, që nëpër qendrat korrektuese të bëhet favorizimi i personelit. Aktualisht nëpër qendra korrektuese konkurset janë të hapura edhe për personat nga jashtë. Mendoj që kjo është një padrejtësi që i bëhet Shërbimit Korrektues në Kosovë sepse nuk mund të hapet konkurs i jashtëm pa pasur konkurs të brendshëm, theksoi Tahiri. Ai shtoi, se kete çështje e ka adresuar dhe tani pret që të ketë përkrahje në këtë drejtim.

Sa i përket qendrave korrektuese, gjendja nuk është e keqe. Sapo të përfundojë qendra e re e paraburgimit në Prishtinë, mendoj se Dubrava do të lirohet nga numri i madh i të paraburgosurve, në mënyrë që të ketë një menaxhim më të mirë të Qendrës Korrektuese të Dubravës, kur dihet se Dubrava gjithmonë ka qenë ajo që i ka sjellë problemet më të mëdha, duke pasur parasysh numrin më të madh të burgosurve.

Për Qendrën Korrektuese të Pejës, tha se nuk ka një përcaktim të domosdoshëm, se një qendër e tillë duhet të mbyllet, por që kushtet për qëndrim aty janë shumë të vështira. Duke i kuptuar edhe shqetësimet e sindikatave, në përgjithësi gjendja është e mire dhe nuk ka probleme të pamenaxhueshme brenda Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ne fund, ministri Tahiri theksoi se janë në proces të rekrutimit të 120 gardianëve të ri dhe se ky numër e kompletton nevojën që ka kjo qendër të oficerëve korrektues.

Nehat Thaçi, tha se rekomandimet që marrim nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore i implementojmë duke ditur se këto rekomandime na bëjnë më profesionalë dhe më të përgatitur. Ai tha, se mbi 80% të të burgosurve vijnë për herë të parë në burgje, ku iu ofrohen programe rehabilituese, në mënyrë që të jenë të gatshëm të qasen prapë në shoqëri. Ndërsa, sa i përket burgut në Pejë, ai tha se aktualisht ky burg ka 94 të burgosur, por për shkak të vjetërsisë që ka, nuk ofron kushte të mjaftueshme, që të mbahen të burgosurit.

Objektivi i Shërbimit Korrektues të Kosovës, është që të burgosurit mos të kthehen më në burgje por të risocializohen në shoqëri. Në burgun e Prishtinës janë rregulluar diku 200 shtretër, po ashtu edhe në burgun e Gjilanit, është ndërmarrë i njëjti veprim.

Thaçi bëri thirrje që të miratohet sa më shpejt Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale sepse për shkak të ligjit, të burgosurit nuk gëzojnë të drejta si në burgjet tjera në rajon, siç janë: ditët e pushimit, pako ushqimore etj. Nëse kthimi i pakos i parapare në ligj nuk kalon, atëherë në planin B, që e kemi sipas modeleve evropiane, do të hapen kantina brenda burgjeve, ku të burgosurit e privilegjuar, do të kenë mundësi të furnizohen sipas nevojës që kanë.

Albulena Haxhiu, tha se gjendja në qendrat korrektuese nuk është ashtu siç e paraqiti drejtori. Po e nisi me Ligjin e Sanksioneve Penale. Të burgosurit me të drejtë e kërkojnë kthimin e pakos ushqimore, kur dihet se ushqimi që e hanë të burgosurit nuk është cilësor. Ndërsa, sa i përket rehabilitimit, ajo tha se është një përqindje e vogël e njerëzve, që e kryejnë burgun e pastaj rehabilitohen. Haxhiu përmendi edhe çështjen e numrit të vogël të punëtorëve socialë, pastaj numrin e vogël të stafit korrektues, nepotizmin, po ashtu edhe diskriminimin dhe standardet e dyfishta tek të burgosurit.

Frashër Krasniqi, tha se burgjet në Kosovë, nuk i kanë as kushtet minimale, duke përmendur trajtimin e mangët në aspektin shëndetësorë, atë edukativo-arsimor. Të burgosurit shkojnë në edukimin e mesëm apo profesional vetëm sa për të kryer këtë procedurë formalisht, mirëpo, nuk ka kurrfarë cilësie. Si çështje tjetër deputeti Krasniqi, tha se nuk ka seleksionim të të burgosurve sepse një i burgosur që është i dënuar për prerje të druve, qëndron në një pavijon me një të burgosur që ka kryer krim të rëndë.

Sami Kurteshi, tha se dëshiron të sqarohet se çka do të thotë termi “i burgosur i privilegjuar” që u përmend më herët. Kurteshi, pyeti se pse nuk ka nëpër institucione të paraburgimit dhe në qendra korrektuese tabelë të të drejtave dhe obligimeve të të burgosurve? Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Korrektues e kanë obligim, që ta bëjnë një përmbledhje të të drejtave dhe të obligimeve të burgosurve, ta nxjerrin në tabelë dhe ta varin në çdo hapësirë ku janë të burgosurit dhe të paraburgosurit.

Arben Gashi, tha se duke ditur se sistemi është mjaftë i komplikuar, pyeti se si komisioni mundet të ndihmojë në aspektin legjislativ. Ndërsa sa i përket programeve edukative, por edhe ato sociale, duhet të shihet, se a duhet të rritet buxheti, sa duhet të jetë kjo rritje, dhe për cilat kategori, pastaj bashkërisht duhet të mundohemi të përmirësojmë aspektin sistemor, legjislativ dhe programor, në mënyrë që me qenë në funksion të kushteve më të mira për të burgosurit dhe në funksion të qëllimit kryesor, që është riedukimi dhe risocializimi i tyre.

Shkumbin Demaliaj, tha se kushtet ne burgun e Gjilanit janë të mira por megjithatë, duhet të bëhet një ndarje që në bazë të veprave të kryera, të bëhet edhe klasifikimi i të burgosurve dhe jo të qëndrojnë të gjithë në një pavijon.

Abelard Tahiri, tha se ka qenë i planifikuar edhe për këtë vit buxheti për 120 gardianë shtesë. Është hapur konkursi, mirëpo, me rekomandim të Avokatit të Popullit, është mbyll herën e parë për shkak të përcaktimit të moshës, pastaj në konsultim po ashtu, me Avokatin e Popullit, është hartuar një rregullore, e cila është miratuar në Qeveri, ku janë përfshirë rekomandimet e Avokatit të Popullit, dhe është hapur sërish konkursi, prandaj, ne nuk kemi problem me buxhet për këta 120 gardianë sepse janë pjesë e buxhetit edhe për këtë vit, por edhe për vitin e ardhshëm, theksoi ministri Tahiri.

Hajdar Beqa, tha se në Projektligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si komision do të punojmë në grupe punuese edhe në mes dy leximeve dhe do të japim kontributin tonë. Përveç dy kërkesave kryesore, heqja e pakos ushqimore dhe e drejta për informim, si e drejtë elementare është edhe mungesa e qëndrueshme menaxheriale, që lidhet me ushtrues detyre, kur dihet se shumica e burgjeve të Kosovës kanë ushtrues detyre. Ndërsa, sa i përket qendrës së paraburgimit në Peje, pyeti ministrin se a ka ndonjë strategji për këtë?

Korab Sejdiu, pyeti se a ka plan Ministria apo edhe drejtori, sa i përket qendrave të paraburgimit? Do të ishte në dobi të të gjithëve, që nga ana juaj të ketë një dokument të shkruar, i cili tregon qartë se ku po synohet të shkohet me këtë reformim të qendrave të paraburgimit?

Nehat Thaqi, tha se të gjithë të miturit dhe të burgosurit kanë të drejtën e arsimimit dhe në fund të vitit certifikohen me diploma zyrtare nga Ministria e Arsimit. Ndërsa sa i përket rehabilitimit të të miturve, ka shumë projekte. Është e vërtetë që ka mungesë të punëtorëve socialë dhe se është bërë kërkesa te ministri për nevojën e punësimit të një numri të caktuar të stafit civil, kryesisht trajner në fusha të ndryshme të rehabilitimit.

Pajtohet që në burgun e Dubravës ka nepotizëm, dhe kontrabandë dhe se pikërisht për çështjen e parandalimit të këtyre dukurive, janë ndërmarrë disa hapa konkret, ku të gjitha produktet ushqimore kontrollohen, hap tjetër është instalimi i disa pajisjeve për ndërprerjen e valëve telefonike, ku në masë të madhe ka zbritur nevojën për të kontrabandë përmes telefonit.

Sa i përket higjienës dhe kushteve, ai tha se Burgu i Gjilanit, Burgu i Sigurisë së Lartë, Burgu i Dubravës dhe Burgu i Prishtinës, kanë higjienë të mirë, ndërsa burgjet e vjetra qëndrojnë pak më dobët.

Tek kategorizimi i të burgosurve, ende nuk ka të burgosur të kategorizuar dhe është stafi i trajnuar për kategorizimin e të burgosurve. Problemi është që në ligjin aktual nuk kemi të drejtë të krijojmë një njësi të re, ndërsa me aprovimin e Ligjit të ri, do të fillojë puna në këtë aspekt.

Për termin i privilegjuar, ai sqaroi se e përdori si term për të burgosurit, të cilët kanë sjellje të mira dhe angazhim në punë.

Sa i përket rekomandimit të tabelave, tha se është rekomandim i mirë, edhe pse të gjithë të burgosurit janë të informuar për të drejtat e tyre përmes avokatëve dhe zyrtarëve socialë.

Sa i përket qendrës së Pejës, shtoi se nuk ka vendim që kjo qendër do të mbyllet, është bërë një rekomandim dhe në bazë të kësaj do të bëhet plani për evakuimin apo transferimin e të burgosurve.

Albulena Haxhiu, tha se na është thënë që kryetari i Komunës së Pejës ka ndarë tokë për ndërtimin e qendrës së re. Gjithashtu, pyetje tjetër znj. Haxhiu pati për përfshirjen në Ligjin e pagave, pse nuk është bërë një kërkesë nga ju si drejtor, po nga sindikata?

Nehat Thaçi, duke iu përgjigjur deputetes Haxhiu, theksoi se disa zyrtarë në emër të sindikatës, kanë bërë kërkesë, në emër të Shërbimit Korrektues, tek kryetari i Komunës së Pejës. Kryetari i Komunës, ka shprehur dëshirë për dhënien e një prone, dhe kjo është arsyeja pse kam kërkuar hetim ndaj zyrtarëve dhe jo ndaj sindikatës.

Sa i përket çështjes së pagave, ai tha se i raportojnë Ministrisë së Drejtësisë, pra, kërkesat janë adresuar në Ministri të Drejtësisë. Ndërsa, sa i përket rehabilitimit dhe risocializimit të të burgosurve, tha se është i vetëdijshëm që Buxheti i Kosovës e ka të pamundur ti mbështesë këto projekte, por që për këto projekte janë kërkuar donacione, disa prej të cilave edhe janë gjetur.

Shkumbin Demaliaj, propozoi që drejtori të bëj një kërkesë për pasurimin e fondit të librave, duke ditur se librat janë botime të vjetra.

Nehat Thaçi, duke falënderuar për rekomandimin, tha se secili paraburgim ka bibliotekë, por që nuk janë të furnizuara sa duhet. Besoj që gjatë viteve 2019-2020, do të trajtojmë këtë çështje, për arsye se është pjesë e rehabilitimit. Shpresojmë që të gjitha këto projekte ti finalizojmë dhe nëse realizohen, besoj që do të krahasohemi me shtetet evropiane.

Nga pika katër e rendit të ditës, kryesimin e mbledhjes e mori Hajdar Beqa, zëvendëskryetari i parë i Komisionit.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr.06-L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;

*Kryesuesi, paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente në Projektligjin nr. 06-L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe meqë nuk pati diskutime, kryesuesi konstatoi se me **katër** vota “për” “një” kundër dhe “një” abstenim, Komisioni nxori këtë:*

R e k o m a n d i m

- I. Miratohet Raporti me amendamente për Projektligjin nr.06-L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
- II. Raporti me amendamente i paraqitet për shqyrtim komisioneve kryesore dhe procedohet për shqyrtim në Kuvend;
- III. Amendamentet e miratuara dhe të pamiratuara, janë aneks i këtij procesverbali.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

Kryesuesi, paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen, nëse kanë vërejtje për këtë raport.

Meqë nuk pati diskutime, kryesuesi konstatoi se Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Komisioni përkrahë procedimin e raportit me amendamente për Projektligjin nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi i Raporteve të Komisioneve Kryesore për Projektligjin nr.06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004-32 për Familjen i Kosovës;

Hajdar Beqa, konstatoi se meqë nuk ka vërejtje nga komisionet kryesore, me shumicë votash procedohet për Kuvend për shqyrtim të dytë Projektligji nr.06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004-32 për Familjen i Kosovës;

7. Të ndryshme.

Në këtë pikë u vendos që të formohet grupi punues për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.06/L-101 Për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

Pas diskutimeve, Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

V e n d i m

Për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.06/L-101 Për të Drejtën Ndërkombëtare Private, në këtë përbërje :

- 1) Shkumbin Demaliaj, kryesues
- 3) Hajdar Beqa, anëtar
- 5) Jelena Bontiq, anëtare.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu

Aneks - amendamentet për Projektligjin nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Amendamenti 1

Neni 1, në titull, hiqen fjalët: “dhe fushëveprimi i Ligjit”.

Amendamenti 2, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 2, nënparagrafi 1.4, përkufizimi: “Qeveria-Qeveria e Republikës së Kosovës”, të hiqet.

Amendamenti 3

Neni 2, nënparagrafi 1.6. hiqet.

Neni 2, pika 1.13, riformulohet si vijon:”1.13. Kryeprokurori i Shtetit është kreu i Zyrës së Prokurorit të Shtetit”.

Në nenin 2, shtohet një paragraf i ri, me përmbajtjen si vijon: “2. Fjalët e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër”.

Amendamenti 4

Neni 3, nënparagrafi 1.2, në rreshtin e katërt, fjala “afirmative”, hiqet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 5, propozim i Grupit Parlamentar Lista Serbe, pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 3, nënparagrafi 1.2 i projektligjit, ndryshohet dhe në fund shtohet: ”dhe parimet ndërkombëtare dhe kushtetuese të përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë”.

Amendamenti 6

Në nenin 3, pas paragrafit 1.3, shtohet paragraf i ri 1.4 si vijon:

“1.4. Siguron që prokuroritë të respektojnë parimet e mosdiskriminimit, proporcionalitetit, si dhe të drejtat e njeriut dhe të barazisë gjinore, të garantuara me Kushtetutë dhe me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare që zbatohen në Republikën e Kosovës;”

Amendamenti 7, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 5 i projektligjit, riformulohet si vijon: “Anëtarët e Këshillit Prokurorial nuk mbajnë përgjegjësi penale apo civile për mendimet e shprehura brenda fushëveprimit të tyre, si anëtarë të Këshillit”.

Amendamenti 8

Neni 7, nënparagrafi 1.1 riformulohet si vijon: ”1.1 Vendos për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të prokurorive sipas ligjit;”.

Neni 7, nënparagrafi 1.2 riformulohet si vijon: “1.2. I propozon Presidentit emërimin, riemërimin dhe shkarkimin e prokurorëve, si dhe siguron se të gjithë kandidatët e propozuar i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj, sipas procedurave përkatëse ligjore;”.

Neni 7, nënparagrafi 1.3, në rreshtin e tretë, fjalët: “si dhe sigurimin”, zëvendësohen me fjalën “siguron” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 7, nënparagrafi 1.4 riformulohet si vijon: “1.4 Vendos për emërimin e kryeprokurorëve të Prokurorive Themelore, Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë së Apelit, në pajtim me Ligjin për Prokurorinë e Shtetit dhe Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës”.

Neni 7, nënparagrafi 1.5, riformulohet si vijon:” 1.5 Siguron zbatimin dhe mbikëqyrë kriteret për pranim në prokurori, të cilat duhet të bëhen në pajtim me parimet e meritës, mundësive të barabarta, barazisë gjinore, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimi të zotësisë së veprimit të kandidatëve;”.

Neni 7, nënparagrafi 1.8 riformulohet si vijon: ”1.8. Vendos dhe mbikëqyrë zbatimin e kriterëve për përbërjen etnike të juridiksionit territorial të prokurorisë përkatëse dhe për plotësimin e vendeve të lira të punës, të garantuara për anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;”.

Neni 7, nënparagrafi 1.12, fshihet fjala “ rregullt të” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 7, nënparagrafi 1.16, riformulohet si vijon:

1.16 ” Miraton Kodin e Etikës profesionale për stafin administrativ, shqiptimin e masave disiplinore të përcaktuara me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shkelja e të cilit paraqet bazë për sanksione”.

Neni 7, nënparagrafi 1.21, në rreshtin e parë, pas fjalës “mbikëqyrjen e”, shtohet fjala “sekretariatit” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 9, dy propozime

A. Propozim i Komisionit funksional

Neni 7, nënparagrafi 1.30, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: “çdo gjashtë muaj”.

B. Propozim i deputetes Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 7, nënparagrafi 1.30, fjala “gjashtë”, zëvendësohet me “tre” si vijon:

“1.30 Raportimin para publikut për zbatimin e objektivave të saj, të përcaktuara në mënyrë specifike dhe të bazuar në indikatorë të matshëm, çdo tre muaj”.

Amendamenti 10

Në nenin 8, në titull, hiqen fjalët: “dhe zgjedhja” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 8, paragrafi 3 riformulohet si vijon:

“3. Tre (3) anëtarët jo-prokurorë të Këshillit, të zgjedhur nga Kuvendi, sipas nenit 65 (10) të Kushtetutës, zgjidhen me votim të fshehtë, me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, bazuar në një listë prej 2 kandidatëve për secilën pozitë të propozuar nga organet përkatëse e që përfshin:

3.1. Një (1) anëtar nga Oda e Avokatëve të Kosovës;

3.2. Një (1) profesor nga fakultetet juridike të Republikës së Kosovës;

3.3 “1 (një) përfaqësues nga shoqëria civile. Përfaqësuesi i shoqërisë civile përzgjidhet me anë të konkursit publik të shpallur nga Kuvendi, i cili duhet të ketë përgatitje të lartë profesionale, njohuri të dëshmuara nga fusha e drejtësisë, njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut, përvojë pune në çështjet ligjore prej 5 (pesë) viteve, dhe përkrahjen e së paku 5 (pesë) organizatave të shoqërisë civile të fushës së drejtësisë”.

Neni 8, me ndryshimet e propozuara bartet pas nenit 9 dhe renditja e neneve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 11, propozim i Grupit Parlamentar Lista Serbe, pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 8, paragrafi 4 i projektligjit, ndryshohet në këtë mënyrë:

“3 anëtarë i zgjedhin anëtarët e Kuvendit, të cilët kanë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit serb në Kosovë”.

Amendamenti 12, propozim i Grupit Parlamentar Lista Serbe, pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 8, paragrafi 4 i projektligjit, shtohet pika 2 si vijon:

“2 anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët kanë vende të rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve tjera jo shumicë në Kosovë”.

Amendamenti 13

Në nenin 9, pas nënparagrafit 1.1, shtohet nënparagraf i ri si vijon:

“1.2 është prokuror me mandat fillestar”.

Renditja e nënparagrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Neni 9, nënparagrafi 1.3 riformulohet si vijon: "1.3 personi që ushtron funksion në cilindo subjekt politik, shoqatë apo fondacion të lidhur me ndonjë subjekt politik;"

Neni 9, nënparagrafi 1.4, në rreshtin e katërt, fjala "themelatat", zëvendësohet me fjalën "institucionet" dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 9, nënparagrafit 1.5, riformulohet si vijon: "1.5 të mos jenë dënuar për veprë penale, me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia".

Amendamenti 14, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 10, paragrafi 3, fjalët " përjashtimisht përfaqësuesit nga shoqëria civile", të hiqen dhe atë si vijon:

10.3 Kuvendi e shpall konkursin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, në media të shkruara dhe elektronike dhe në gjuhët zyrtare.

Amendamenti 15

Në nenin 10, paragrafi 8, në rreshtin e dytë, fjala "pozicion", zëvendësohet me fjalën "pozitë".

Amendamenti 16

Në nenin 10, paragrafi 9 riformulohet si vijon: " 9. Nëse në rrethin e parë, kandidatët e propozuar nga komisioni përkatës i Kuvendit nuk marrin shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, atëherë në raundin e dytë konsiderohet i zgjedhur kandidati me numrin më të madh të votave".

Amendamenti 17, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 10, paragrafi 10.10, të riformulohet si në vijon:

10. Shkarkimi i anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit, bëhet nga Kuvendi me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, me propozim të komisionit përkatës ose Këshillit.

Amendamenti 18

Neni 11, paragrafi 1, riformulohet si vijon: 1."Këshilli nga radhët e anëtarëve të vet prokurorë, zgjedh kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin, me mandat 3 vjeçar. Zgjedhja në këto funksione nuk e zgjat mandatin e anëtarit të Këshillit."

Neni 11, nënparagrafi 2.2 riformulohet si vijon: "2.2 Miraton rendin e ditës dhe pikave që do t'i dërgohen Këshillit për konsiderim dhe vendim".

Neni 11, nënparagrafi 2.3 riformulohet si vijon: "2.3 Përfaqëson Këshillin".

Në nenin 11, nënparagrafi 2.6, pas fjalës raport, shtohet fjala “ me shkrim” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 11, paragrafi 5 riformulohet si vijon: 5. “Zëvendëskryesuesi ka autoritet të plotë për të vepruar në emër të Këshillit, në rast të mungesës apo paaftësisë së kryesuesit”.

Amendamenti 19

Neni 12, paragrafi 1 riformulohet si vijon: ”1 Anëtarët e Këshillit qëndrojnë në detyrë për një mandat 5 vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.”

Në nenin 12, paragrafi 2 riformulohet si vijon: “2. Kryesuesi, zëvendëskryesuesi, kryetari i Komisionit për Çështje Normative, kryetari për Çështjen e Vlerësimin të Performancës dhe kryetari për Administrimin e Prokurorive, shërbejnë në Këshill me kohë të plotë dhe pezullojnë detyrën e prokurorit.”

Amendamenti 20

Neni 13, nënparagrafi 1.2 riformulohet si vijon: “1.2 humbjen e zotësisë për veprim”.

Neni 13, nënparagrafi 1.3 riformulohet si vijon: “1.3 dështimin e vazhduar për të marrë pjesë në veprimtaritë e Këshillit më gjatë se 3 (tre) muaj, pa arsye të vërtetuar”.

Neni 13, nënparagrafi 1.8 riformulohet si vijon: “1.8 është dënuar për veprë penale, me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia”.

Në nenin 13, në paragrafin 4, fjala “anëtarët”, zëvendësohet me fjalën “radhët” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 21

Neni 17, paragrafi 1 riformulohet si vijon:”1. Këshilli harton buxhetin vjetor, në pajtueshmëri me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.”

Amendamenti 22

Neni 18, paragrafi 3 riformulohet si vijon:” 3. Gjatë mandatit të tyre, kryesuesi, si dhe anëtarët prokurorë, me orar të plotë pranojnë vetëm pagën e përcaktuar me ligj, përveç për rimbursime të shpenzimeve të arsyeshme dhe të nevojshme që ndërlidhet me ushtrimin e detyrave të tyre, siç përcaktohet në paragrafin 5 të këtij neni.

Në nenin 18, në paragrafin 4, fjalët: “skadimin e shërbimit”, zëvendësohen me fjalët “përfundimin e mandatit” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 18, në paragrafin 5, në rreshtin e fundit, pas fjalës “të lartë”, shtohen fjalët “Akademisë së Drejtësisë” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 23

Neni 20, nënparagrafi 2.5 riformulohet si vijon: "2.5 aftësinë për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, të ndershme, me kujdes dhe me përgjegjësi;"

Neni 20, nënparagrafi 2.7, hiqet.

Neni 20, pas paragrafit 4, shtohet një paragraf i ri 5, me përmbajtjen si vijon: "5. Procedura për vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatit për t'u bërë pjesë e prokurorisë, do të bëhet përmes vërtetimit të të dhënave të dorëzuara nga kandidati, të dhënat nga regjistrat publikë relevantë për vlerësim, përfshirë verifikimin standard të regjistrave për të kaluarën kriminale".

Renditja e paragrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 24, propozim i Grupit Parlamentar Lista Serbe, pa përkrahjen e Komisionit funksional

Ndryshohet neni 20, paragrafi 5 i projektligjit si vijon:

"në qoftë se ekzistojnë kandidatë me kualifikime të njëjta, prioritet duhet t'i jepet përfaqësuesve të komuniteteve pakicë".

Amendamenti 25, dy propozime

A. Propozim i deputetit Hajdar Beqa, me përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 21 – Njësia për Verifikim

Neni fshihet në tërësi.

B. Propozim i deputetes Fitore Pacolli, pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 21, paragrafi 1, duhet të ndryshohet si vijon:

1. Procedura për verifikimin e të kaluarës së kandidatit duhet të bëhet me kujdes maksimal dhe në mënyrë strikte, në pajtim me parimet e sundimit të ligjit. Këshilli mund të kërkojë një kontroll standard për dosje penale dhe baza të tjera nga policia, nëse të dhënat e ofruara nga policia rreth të kaluarës së kandidatit, të cilat bien në kundërshtim me ligjin, mund të rezultojë në diskualifikim të kandidatit.

Amendamenti 26

Në nenin 22, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

1 "Këshilli, përmes një njoftimi publik fton të gjithë personat e kualifikuar ligjorë që të aplikojnë për kandidatë për emërimë në Prokurorinë e Shtetit".

Amendamenti 27

Në nenin 26, paragrafi 1 riformulohet vijon:

“1. Prokurorët mund të shkarkohen nga funksioni, për shkak të:

1.1 “është dënuar për veprë penale, me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia; dhe”

1.2 “mosrespektimin e rëndë të detyrave”.

Në nenin 26, në paragrafin 6, në rreshtin e gjashtë, fjalët: ”tjetër kandidatin e propozuar”, zëvendësohen me fjalët: “ propozimin për shkarkimin e prokurorit” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 28

Në nenin 29, në paragrafin 1, në rreshtin e fundit, fjalët 6 (gjashtë) muaj për një herë”, zëvendësohen me fjalët: “1 (një) vit”.

Amendamenti 29

Në nenin 31, në titull, fjala “njësia”, zëvendësohet me fjalën ”njësi” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 31, paragrafi 1, në rreshtin e parë, fjala “njësia”, zëvendësohet me fjalën “ njësi” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 31, paragrafi 2, në rreshtin e tretë, fjala “njësisë”, zëvendësohet me fjalën “ njësitit” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 30

Neni 33, paragrafi 2 riformulohet si vijon: “2. Këshilli cakton pagën e drejtorit të sekretariatit, në pajtim me legjislacionin në fuqi”.

Amendamenti 31

Neni 34, në paragrafin 3, fjala “njësisë”, zëvendësohet me fjalën “njësitit” dhe teksti vazhdon si në projektligj.